

ANKETA PËR QASJEN E NDËRMARRJEVE NË BURIMET FINANCIARE (SAFE)

Të nderuar zonja/zotërinj,

Kompania për hulumtimin e politikave, Panteia, dhe kompania e pavarur private për hulumtimin e tregut, GDCC, të dyja me seli në Holandë, po realizojnë një anketë të rëndësishme për llogari të Komisionit Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE) dhe kanë kënaqësinë të ftojnë kompaninë tuaj në këtë anketë.

Komisioni dhe BQE-ja dëshirojnë të kuptojnë më mirë situatat dhe rrethanat me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si edhe firmat e mëdha jofinanciare kur qasen në mjete financiare nga banka dhe burime të tjera financuese. Anketa po realizohet anëmbanë Evropës dhe përgjigjet e saj do ta ndihmojnë Komisionin në politikëbërjen e vetë për të përmirësuar qasjen në burime financiare të ndërmarrjeve si juaja, si dhe BQE-në në zhvillimin e politikave të veta monetare.

Intervista zgjat afërsisht 15 minuta. Ajo kryhet me telefon dhe në pajtim me kodin ndërkombëtar ICC/ESOMAR për hulumtimet e tregut dhe ato sociale. Kjo do të thotë se përgjigjet tuaja do të mbeten plotësisht konfidenciale. Dëshira jonë është të bisedojmë me personin më të përshtatshëm për të folur mbi financimin e kompanisë suaj – nëse ky person nuk jeni ju, lutemi të na bëni me dije se kur mund t'ju telefonojmë sërish. Intervistat do të mbahen gjatë javëve në vijim.

Nëse keni mundësi të merrni pjesë, do t'ju dërgojmë një përmbledhje të gjetjeve të anketës pas përfundimit të studimit.

Nëse dëshironi të merrni më shumë informacion për projektin, ju lutemi të kontaktoni GDCC-në në survey.accesstofinance@gdcc.com ose BQE-në në survey.accesstofinance@ecb.europa.eu.

Me respekt,



Ioannis Ganoulis
Drejtor i Statistikave Monetare dhe
Ekonomike,
Banka Qendrore Evropiane



Kristin Schreiber
Drejtoreshë, Programi COSME,
Departamenti i Rritjes së Tregut të
Brendshëm, Industrisë,
Sipërmarrjes dhe Ndërmarrjeve të
Vogla e të Mesme,
Komisioni Evropian